

Zgjidhje ideore dhe realizim të brendimit të ndërtesës së Universitetit të Evropës Juglindore – ish-objekti afarist “MOST” – Shkup

Të interesuarit duhet të ofrojnë zgjidhje ideore për brendimin komplet të ndërtesës së Universitetit të Evropës Juglindore –ish-objekti afarist “MOST” – Shkup, duke pasur parasysh veprimtarinë e Universitetit, me qëllim të ndërtimit të identitetit pamor.

Pjesët të cilat planifikohen të brendohen:

1. Dritare, përafërsisht 140 metra gjatësi dhe 0.6 metra gjerësi (lartësi), të brenduar me foli (PWC one way vision)
2. 4 hapësira përafërsisht 9x 4 m (me pwc frontlite –taroulin 900 gram)
3. **Logoja e UEJL-së dhe emri i punuar në 3D nga pleksigllasi - opsionet si ne vijim:**
 - a) Logoja e punuar në 3D me diametër 3-4 m (të rrotullohet vetëm pjesa e brendshme pa rrethin), me ndriçim me led dioda, e vendosur mbi kulmin e ndërtesës.
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY punuar në 3D nga pleksigllasi, me ndriçim me led dioda e vendosur mbi platformën e katit të parë. Emri në anglisht **SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY** i shtrirë në sipërfaqe prej 15-20 m gjatësi dhe i ngritur nga platforma përafërsisht 1.5 m lartësi me qëllim të dukshmërisë më të mirë **(projekti statik dhe leja e vendosjes të sigurohet nga ofruesi).**
 - b) Logoja (të rrotullohet vetëm pjesa e brendshme) dhe emri i UEJL-së e në tre gjuhë **(UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE, УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА, SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY)** e punuar në 3D nga pleksigllasi , me ndriçim me led dioda e vendosur mbi platformën e katit të parë. Logoja dhe emri në tri gjuhë të shtrira në sipërfaqe prej 15-20 m gjatësi dhe të ngritura nga platforma përafërsisht 1.5 m lartësi me qëllim të dukshmërisë më të mirë.